



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"**

**RREGULLORE E PROGRAMIT**  
**TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE**  
**"MASTER I SHKENCAVE" NË "FARMACI"**

(Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik)

Vlorë, 2017



---

## **KREU 1**

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Objekti i Rregullores**

Rregullorja e programit “Master i shkencave” në “Farmaci” percakton parimet e funksionimit te ketij programi, ne Kolegjin Universitar “Reald”, (më poshtë KUR).

#### **Neni 2**

##### **Baza Ligjore**

Rregullorja mbështetet në ligjin për arsimin e lartë, në Statutin e KUR, në Rregulloren e përgjithshme të KUR, si dhe në aktet e tjera nënligjore.

## **KREU 2**

### **PERMBAJTJA E PROGRAMIT**

#### **Neni 3**

##### **Objektivat formues specifike te programit**

Objektivi kryesor i programit “Master i shkencave” në “Farmaci” eshte t’u jape studenteve njohurite e nevojshme per formimin e tyre si spacialist farmacist.

Ne funksion te ketij objektivi programi synon dhenien e nje teresie njohurish ne formimin e pergjithshem teorik dhe praktik ne fushen e specialitetit farmaci me objektiv kryesor formimin e specialisteve ne keto fusha, te afte per te punuar si specialist farmacist dhe per realizimin e studimeve te avancuara ne kete fushe.

Per realizimin e ketij objektivi programi parashikon harmonizimin e njohurive duke filluar me ato baze teorike, te fushes dhe ndihmese duke vijuar me thellime ne aspektin praktik.

Programi synon te pergatise specialist farmacist te afte per te punuar si ne sektorin privat dhe ne ate shteteror.

Gjithashtu, ky program synon te pergatise specialist te afte per vazhdimin e studimeve te metejshme ne fushen e mjekesise.



Ne perfundim te programit, studenti aftesohet per t'u punesuar ne njesite e ndryshme farmaceutike si ne sektorin privat ashtu edhe administraten publike.

Njohurite qe ofrohen nga ky program dhe kompetencat qe marrin studentet nepermjet tij krijojne bazen per nje karriere kerkimore dhe akademike duke mundesuar vazhdimin e studimeve te ciklit te dyte dhe te trete.

#### Neni 4 Plani per programin "Master i shkencave" ne "Farmaci"

Nr	Lëndë/Module	Tipi i veprimit	Semestri	ECTS	Orë mësimore				Frekuentimi
					Leksione	Semina re	Laborat or	Totali	
1	Kimi e përgjithshme dhe Inorganike	A	I	6	30	30	15	75	I detyrueshëm
2	Fizikë	A	I	3	20	5	5	30	I detyrueshëm
3	Biologji	A	I	3	20	10	0	30	I detyrueshëm
4	Statistikë	A	I	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
5	Anatomi	B	I	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
6	Latinisht	E	I	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
7	Gjuhë e huaj1 Anglisht-gjermanisht	D	I	3	0	30	0	30	I detyrueshëm
8	Kimi e përgjithshme dhe Inorganike	A	II	6	30	30	15	75	I detyrueshëm
9	Fizikë	A	II	3	20	5	5	30	I detyrueshëm
10	Biologji	A	II	5	30	15	0	45	I detyrueshëm
11	Anatomi	B	II	4	40	0	0	40	I detyrueshëm
12	Informatikë	E	II	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
13	Latinisht	E	II	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
14	Gjuhë e huaj1 Anglisht-gjermanisht	D	II	3	0	30	0	30	I detyrueshëm
15	Kimi Organike	A	III	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
16	Kimi Fizike	B	III	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
17	Mikrobiologji	B	III	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
18	Fiziologji	B	III	3	20	10	0	30	I detyrueshëm
19	Kimi Analitike	B	III	3	20	10	0	30	I detyrueshëm
20	Botanikë	B	III	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
21	Gjuhë e hua 2 Anglisht-Italisht	D	III	3	0	30	0	30	I detyrueshëm



22	Kimi Organike	A	IV	9	30	30	30	90	I detyrueshëm
23	Fiziologji	B	IV	4	30	15	0	45	I detyrueshëm
24	Kimi Analitike	B	IV	7	30	15	20	65	I detyrueshëm
25	Sistematikë	C	IV	7	30	20	20	70	I detyrueshëm
26	Gjuhë e hua 2 Anglisht-Italisht	D	IV	3	0	30	0	30	I detyrueshëm
27	Kimi Farmaceutike 1	B	V	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
28	Teknologji Farmaceutike 1	B	V	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
29	Farmakognozi	B	V	5	30	0	20	50	I detyrueshëm
30	Biokimi	B	V	3	20	10	0	30	I detyrueshëm
31	Higjenë	C	V	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
32	Kimi Farmaceutike 1	B	VI	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
33	Teknologji Farmaceutike 1	B	VI	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
34	Farmakognozi	B	VI	5	30	0	20	50	I detyrueshëm
35	Biokimi	B	VI	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
36	Njohuri mbi sëmundjet	C	VI	6	30	30	0	30	I detyrueshëm
37	Kimi Farmaceutike 2	B	VII	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
38	Teknologji Farmaceutike 2	B	VII	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
39	Kimi Ushqimore	B	VII	3	30	0	10	40	I detyrueshëm
40	Etikë- dontologji Mjeksi Ligjore	D	VII	6	60	0	0	60	I detyrueshëm
41	Farmakologji	B	VII	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
42	Kimi Toksikologjike	B	VII	2	20	0	0	20	I detyrueshëm
43	Kimi Farmaceutike 2	B	VIII	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
44	Teknologji Farmaceutike 2	B	VIII	8	30	30	20	80	I detyrueshëm
45	Kimi Ushqimore	B	VIII	2	20	0	0	20	I detyrueshëm
46	Legjislacion Farmaceutik	C	VIII	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
47	Farmakologji	B	VIII	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
48	Kimi Toksikologjike	B	VIII	3	30	0	0	30	I detyrueshëm
49	Kimi Farmaceutike 3	B	IX	7	30	20	20	70	I detyrueshëm
50	Teknologji Farmaceutike 3	B	IX	7	30	20	20	70	I detyrueshëm
51	Farmakologji Klinike	B	IX	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
52	Biofarmaci	B	IX	6	30	30	0	60	I detyrueshëm
53	Fitoterapi	C	IX	4	20	20	0	40	I detyrueshëm
54	Praktikë	E	X	20				370	
55	Teza e diplomës	F	X	10				80	



## **Neni 5 Kurrikulat**

Kurrikulat e ofruara studenteve gjate programit “Master i shkencave” në “Farmaci” ne Fakultetin e Shkencave Mjekesore, në KUR, gjenden bashkelidhur kesaj rregulloreje.

## **Neni 6 Forma e studimit, provimeve dhe verifikimeve te tjera te dijeve te fituara nga studentet**

1. Forma e studimeve te programit “Master i shkencave” në “Farmaci” eshte me kohe te plote.
2. Programi perbehet nga lende te organizuara ne module, duke perfshire praktiken profesionale dhe temen e diplomes.
3. Procesi mesimor perbehet nga leksionet, punet e laboratorit, projektet dhe detyra, praktiket, seminare dhe punime te tjera te ngjashme te parashikuara ne programin mesimor.
4. Vleresimi nga pikepamja akademike leksionet, punet e laboratorit, projektet dhe detyra, praktiket mesimore, seminare dhe punime te tjera te ngjashme behet ne baze te njesise matese ore te zhvilluar ne auditor si dhe ore pune te pavaruara studimore te kryer nga studenti.
5. Nje krediti te formimeve akademike i korrespondojne 25 ore mesimore pune studenti. Sasia mesatare e punes se kryer gjate nje viti studimesh akademike nga nje student me kohe te plote eshte 60 kredite. Keto perfshijne ore ne auditor dhe ore pune te pavarur te tij.
6. Niveli i suksesit te studentit vleresohet mbi bazen e provimeve semestrale/vjetore; provimeve te fundvitet; detyrave te kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve.

## **Neni 7 Frekuentimi**

1. Stundeti ne program ka detyrim te ndjeke te pakten 75% te seminareve, 50 % leksione dhe 100% laboratore, ushtrime dhe praktika.



2. Studentet te cilet nuk i realizojne keto norma duhet ta rimarrin perseri ate lende me te gjitha detyrimet perkatese.
3. Plotesimi apo jo i kushteve ne lidhje me pjesemarrjen, i paraqitet pergjegjesit te departamentit nga ana e pedagogut te lendes cdo muaj dhe kontrollohet nga pergjegjesi i departamentit.

### **Neni 8 Vleresimi**

Vlerësimi bëhet me pikë (përfshire pikët e vleresimit gjatë vitit) dhe konvertimi në nota do te jetë:

- 50 pike	-----	nota 5
- 51 – 60 pike	-----	nota 6
- 61 – 70 pike	-----	nota 7
- 71 – 80 pike	-----	nota 8
- 81– 90 pike	-----	nota 9
- 91 – 100 pike	-----	nota 10

### **KREU 3 PROCEDURA E PRANIMIT TE STUDENTEVE**

#### **Neni 9 Kushtet e domosdoshme per aplikim ne programin**

Studentet te cilet zoterojne nje diplome qe verteton perfundimin e matures, ata persona qe zoterojne nje diplome tjeter studimi te fituar jashte vendit, te vleresuar ekuivalente me te, ose ata qe zoterojne nje diplome te leshuar nga nje institucion i arsimit te larte kane mundesine te aplikojne per t'u pranuar ne programin "Master i shkencave" në "Farmaci" qe ofron KUR.

Perzgjedhja e kandidateve behet nga nje komision i caktuar nga dekanati mbeshtetur ne dokumentacionin e paraqitur si dhe nepermjet intervistes duke mar parasysh dhe mesataren.



---

## **Neni 10**

### **Procedurat e perzgjedhjes**

1. Metoda e perzgjedhjes konsiston ne perzgjedhjen e studenteve nepermjet konkurimit te dosjeve. Kriteret e vleresimit vendosen nga Senati Akademik dhe publikohen. Kane perparesi ne vleresim:
  - Mesatarja e notave te shkolles se mesme
  - Referenca e kandidatit per student.
2. Kur komisioni e vlereson te nevojshem, mund te therrase per interviste te gjithë kandidatet ose ata qe e sheh te arsyeshme.
3. Komisioni vendos me shumice te thejshte per perzgjedhje e kandidateve fitues. Vendimi i tij duhet te merret jo me vone se 5 dite nga mbarimi i afatit te paraqitjes se kerkesave nga kandidatet.

## **Neni 11**

### **Shpallja e fituesve**

Komisioni shpall listen e studenteve fitues ne stendat e fakultetit sipas afatti te deklaruar.

## **Neni 12**

### **E drejta e ankimit**

Pas shpalljes se kandidateve fitues Komisioni merr ne shqyrtim ankimet dhe u jep pergjigje atyre Brenda 48 oreve. Nese kandidati i ankimuar mbetet akoma i paqarte nga pergjigja e dhene nga komisioni perzgjedhes, ceshtja i kalon per shqyrtim Keshillit te Fakultetit, i cili merr vendim perfundimtar lidhur me ankimin.

## **Neni 13**

### **Transferimi i studenteve**

1. KUR pranon transferime te studenteve ne vitet ndermjetese nga institucionet e tjera te arsimit te larte vendase ose te huaja, publike ose private dhe lejon transferimin e studenteve te saj ne institucione te tjera te arsimit te larte, sipas procedurave te parashikuara ne kete rregullore.
2. Student qe deshiron te transferohet nga nje institucion i arsimit te larte ne KUR duhet ti paraqese nje kerkese rektoratit te kesaj shkolle ku te parashtroje arsyet e transferimit.



3. Se bashku me kerkesen duhet te paraqese nje kopje te diplomes se shkolles se mesme (te noterizuar ), detyrimet e shlyera ne shkollen derguese me notat perkatese, nje kopje te programeve te disiplinave te shlyera dhe nje dokument identifikimi.
4. Dokumantacioni i percillet Fakultetit perkates, i cili ben vleresimin e lendeve sipas programeve te tij mesimore, percakton programin e studimit ku duhet te vazhdoje aplikanti dhe provimet plotesuese qe ai do te duhet te shlyeje, nese eshte e nevojshme.
5. Rektorati pasi merr mendimin e dekanatit te fakultetit, njofton kerkuesin per pranimin e kerkeses dhe urdheron rregjistrimin e tij.
6. Ne cdo rast kerkuesi duhet te pranoje pagesen e tarifes nga dita e rregjistrimit.

#### **Neni 14** **Numri i studenteve**

Numri minimal i studenteve ne programin te integruar “Master i shkencave” në “Farmaci” eshte 7 shtate dhe ai maksimal eshte 100 (njqind).

Per zhvillimin e veprimtarive praktike te procesit mesimor grupet mesimore ndahen ne grupe me rreth 25-30 studente ndersa per laboraret ngahen ne grupe me 12 - 15 studente.

#### **Neni 15** **Sigurimi i cilesise**

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (ne vijim NJSBC) është njësi autonome operative në strukturën organizative të KUR. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të KUR.

Detyrat e NJSBC janë si më poshtë:

1. Kryen vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe stafit të përfshire në të;
2. Kryen vlerësimin e programeve të reja që do të hapen duke i paraqitur mendim të detajuar Senatit Akademik;
3. Kryen vlerësimin me transparence dhe publikon rezultatin e tij.
4. Harton raportin duke paraqitur në të mangësitë, realizimet si dhe propozon masa konkrete për rritjen e cilësisë së mesimdhënieve ne KUR duke u përfshire ne organizimin cilesore per rritjen e efektshmerine maksimale te mesimdhënieve





dhe mardhenieve student-pedagog, duke patur parasysh strategjine e meposhtme:

- Te rrit profilin e Sigurimit të Cilësisë duke kultivuar një kulturë cilësie në KUR;
- Te siguroj vijueshmërinë periodike dhe të përvitshme të programit të Sigurimit të Cilësisë;
- Te lehtësoje grumbullimin e informacionit mbi raportet e Sigurimit të Cilësisë;
- Te lehtësoj reagimin (feedback) dhe linjat e drejtimit për përpiluesit e rishqyrtimeve dhe raporteve;
- Te lehtësoj dhe inkurajon stafin në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit;
- Te administroj të dhënat statistikore më qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë;
- Te marre përgjegjësinë për çdo lloj procesi shtesë të Sigurimit të Cilësisë, rishqyrtimeve periodike, etj;
- Te marre drejtimin në përgatitjen e dokumenteve për qëllime të jashtme si: akreditimi, bashkëpunimi i KUR me organizata dhe institucioneve relevante
- Te pajis Rektorin me raport mbi sigurimin e cilësisë;
- Te asistoj dekanët dhe fakultetet në zhvillimin dhe vënien në jetë të procedurave për verifikim dhe përmirësim të cilësisë;

## Neni 16

### Financimet dhe kostot e menaxhimit

1. Kostot e diplomes “Master i shkencave” në “Farmaci” perballohen kryesisht nga te ardhurat (hyrjet) e siguruara nga tarifat e rregjistrimit (aplikimit) te kandidatëve si dhe tarifat e shkollimit te studentëve te rregjistruar pranë KUR.
2. Kostot e menaxhimit te programit “Master i shkencave” në “Farmaci” ndahen si me poshte:

- Shperblimi per organizimin e programit dhe drejtimin e tij	10 %
- Shperblimi per oret mesimore te personelit akademik	60 %
- Materiale didaktike, bibliografike etj.	10 %
- Blerje materialesh te inventarizueshme	8 %



- 
- |  |     |
|--|-----|
| - Shpenzime per promovimin e programit | 3 % |
| - Shpenzime te tjera                   | 9 % |

#### **KREU 4 DISPOZITA TE FUNDIT**

##### **Neni 17 Miratimi dhe zbatimi i Rregullores**

Kjo rregullore hyn ne fuqi ne ditën e miratimit te saj ne Senatin Akademik dhe zbatimi i saj sigurohet nga rektori.

**R E K T O R I**  
**Prof. Dr. Petrit KOTORI**